



**AKTI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË  
ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“t b s 96” SH.P.K**

Në Tiranë, sot më dt. 24.03.2006 , unë, Artan Xhori, i biri i Rakos, i datëlindjes 06.10.1963, lindur në Vlore dhe banues në Tiranë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, në mbështetje të nenit 2 të Ligjës 7512, datë 10.08.1991 “Për sanksionimin e pronës private dhe privatizimit, nismës së lirë të veprimtarisë private”. Ligjit Nr. 7638, dt 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, Ligjit 7667, dt. 28.01.1993 “Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar”, vendosa të hartoj këtë Akt-Themelim, për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “t b s 96 ”, mbështetur në parimet e mëposhtme.

**NENI 1**

Themeluesi, Ortak i Vetëm, do të krijojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të cilën do ta emërhojë “t b s 96 ” sh.p.k.

**NENI 2**

Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë, Rr. “Qemal Stafa” P 120 katë 12/C.  
Me vendim të ortakut të vetëm mund të hapen seli sekondare.

**NENI 3**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 10 vjet, me te drejte zgjatje te afatit dhe do të fillojë nga momenti i rregjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar, me përjashtim të rastit kur mbaron sipas parashikimeve në ligj ose kur vendos ortaku i vetëm.

**NENI 4**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- Import ,eksport dhe tregetim mallrash,ne vecanti atyre elektrike,elektronike,radiotelevizive dhe te telekomunikacionit.
- Projektim,instalim,mirembajtje ,sherbime te rrjeteve radiotelevizive, satelitore dhe telekomunikacionit.

**NENI 5**

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 100.000 (*njëqindmijë*) lekë

**NENI 6**

Kapitali themeltar është depozituar prej themeluesit, në emër të shoqërisë ne Banken Kombetare Tregetare Tirane.

**NENI 7**

Shoqëria do të respektoje sa parashikohet ne aktin e themelimit , ne norma të përcaktuara në statutin e saj dhe legjislacionin qe rregullon shoqerite tregetare.

**NENI 8**

Administrator i shoqerise eshte ortaku i vetem i saj Artan Xhori.

**NENI 9**

Ky akt themelimi pasi perpilohet,lexohet e nenshkrurat me vullnetin e lire nga themeluesi i saj Artan Xhori,ne prani te noterit.

**THEMELUESI I SHOQERISE TREGETARE  
“ t b s 96 “ SH.P.K**

**ORTAKU I VETËM  
Artan Xhori**



**STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEJGËSI TË KUFIZUAR  
“t b s 96” SH.P.K**

**FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA**

**NENI 1**

Shoqëria tregetare “t b s 96” sh.p.k, më poshtë e quajtur shoqëria, formohet nga ortaku i vetëm si themelues Z. Artan Xhori, i biri i Rakos, banues në Tiranë.

**NENI 2**

Shoqëria është krijuar në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe si person juridik e fillon aktivitetin me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar.

**SELIA**

**NENI 3**

Selia e shoqërisë është në Tiranë, Rr. “Qemal Stafa” P. 120 katër 12/C Tirane. Ajo mund të ndryshojë selinë e saj me vendim të ortakut të vetëm.

**NENI 4**

Shoqëria e zhvillon aktivitetin në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me statutin e saj, në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Shoqëria mund të krijojë filiale në vende të tjera në përputhje me legjislacionin e vendit përkatës.

**FUSHA E AUTORITETIT TË ORTAKUT**

**NENI 5**

Fusha e autoritetit të ortakut dhe përqindja e fitimeve ose humbjeve do të kenë si kriter bazë kapitalin e shoqërisë, si dhe kompetencat që gëzon në marrjen e vendimeve të çdo karakteri, të përcaktuara në këtë statut.

**LIBRI I SHOQËRISË**

**NENI 6**

Për të preçizuar e për të saktësuar veprintarinë e vetë ekonomike si dhe marrëdhëniet e punës, shoqëria do të çeli librin e vet, i cili do të quhet “Libri i Shoqërisë”.





## KONFIDENCIALITETI

### NENI 7

Ortaku i vetëm si dhe personat e tjerë të pranuar në shoqëri, bien dakort që të mos i ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që do të disponojet shoqëria, kontratat që ajo lidh, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

### NENI 8

Të gjitha aktet dhe dokumentet që nxirren nga shoqëria dhe të destinuara për të tretët si letrat, faturat, lajmërimet dhe publikimet e ndryshme etj, duhet të tregojnë lexueshëm emrin e shoqërisë dhe pas tij fjalët "shoqëri me përgjegjësi të kufizuar", ose inicialet "sh.p.k" dhe emrin e administratorit.

## OBJEKTI

### NENI 9

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- Import eksport dhe tregetim mallrash ne vecanti atyre elektrike,elektronike,radiotelevizive dhe telekomunikacionit.
- Projekte,instalime,mirembajtje,sherbime te rrjeteve radiotelevizive, satelitore dhe telekomunikacionit.

## KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

### NENI 10

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj 10 vjet,me te drejte zgjatje afati, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar, me përashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj, ose me vendim të ortakut të vetëm.

## KAPITALI THEMELTAR

### NENI 11

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (*njëqindmijë*) lekë Ky kapital është tërësisht i nenshkruar ose i shlyer nga ortaku i vetëm. Shoqëria mund të shtojë ose pakësojë kapitalin e saj sipas vendimit të ortakut të vetëm.

## KONTRIBUTET

### NENI 12

Kapitali themeltar përbëhet nga kontributi i mëposhtëm:

- Z. Artan Xhori ka derdhur shumën prej 100.000 (*njëqind mijë*) lekësh.

## LËNIA DHE TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT

### NENI 13

Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm tek personat e tretë, në qoftë se ortaku i vetëm vendos për këtë. Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme në rast ndarje pasurore mes bashkëshortëve si edhe në rrugë trashëgimie.

## STRUKTURA JURIDIKE DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

### NENI 14

Atributet e asamblesë do të kryhen nga ortaku i vetëm, i cili miraton llogaritë, nëse është e nevojshme pas raportit të ekspertëve kontabël të autorizuar, brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit finanziar, merr vendim për ndryshimin e masës së kapitalit filletar dhe shndërrimin e shoqërisë në një formë tjetër, për punësimin e punonjësve dhe pagat e probleme të tjera të lidhura me punësimin në zbatim të legjisacionit shqiptar, etj.

### NENI 15

Shoqëria drejtohet nga një administrator, funksion që kryhet nga ortaku i vetëm z. Artan Xhori.

Ortaku i vetëm merr vendim për emërimin e një ose më shumë administratorëve të tjera. Në këtë rast, emërimi i tij do të bëhet për një afat prej 3 (*tre*) vitesh finanziarë, me përjashtim të rasteve të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm.

### NENI 16

Në rast të emërit të një administratori jo ortak, ai, në marrëdhënie me ortakun dhe të tretët, ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë dhe në emër të saj, nëpërmjet veprimeve që janë në përputhje me objektin e shoqërisë, me përjashtim të atyre kompetencave që ligji dhe statuti ia japin shprehimisht ortakut.



Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve qoftë për shkelje ligjore, qoftë për shkelje të statutit ose për faje të kryera gjatë administrimit të tij.

## **LIBRAT E SHOQËRISË, BILANCI, SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI**

### **NENI 17**

Shoqëria është e detyruar të mbajë përvèç dokumentacionit kontabël ose librave të tjera, edhe:

- Librin e shoqërisë, në të cilin shënohet emri i plotë i ortakut dhe kapitali themeltar, si dhe vendimet e ortakut të vetëm.

### **NENI 18**

Për punonjësit që do të punësohen, marrëdhëniet juridike midis shoqërisë dhe të punësuarve do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punës në përputhje me dispozitat ligjore dhe kodin e punës.

### **NENI 19**

Shoqëria merr përsipër të derdhë rregullisht të gjitha detyrimet, gjithashtu dhe kontributet për sigurimin e të punësuarve të saj në organet kompetente përkatëse sipas ligjit.

## **BILANCI**

### **NENI 20**

Bilanci mbylljet në 31 Dhjetor të çdo viti, ku i pari do të jetë 31 Dhjetori i vitit 2006. Ilogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit finansiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël i autorizuar nga ortaku, miratohen nga ortaku i vetëm.

Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit finansiar.

## **DIVIDENTET**

### **NENI 21**

Pas miratimit të llogarisë vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, që përbëhet nga fitimi i vitit finansiar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna përfondin rezervë të domosdoshëm të përcaktuar nga ortaku, si dhe të fondeve



të jtera që shihen të nevojshme, si dhe janë zbritur ose janë shtuar përkatësisht humbjet apo fitimet e mbartuara nga vitet e mëparshme, ortaku i vetëm përcakton dhe dividentet e realizuar mbi fitimin.

## **SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI**

### **NENI 22**

Shoqëria mbaron me vendim të ortakut të vetëm ose kur ka një prishje të parakohshme për arsyet e parashikuara në ligj.

### **NENI 23**

Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi ortaku cakton një ose disa likuidues, të cilët i paraqesin atij raportin mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit të shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre. Në fund të procesit të likuidimit, ortaku vundos mbi bilancin përfundimtar financier dhe mbi mbylljen e procesit të likuidimit. Pas pagimit të kreditorëve ortaku i vetëm mban pjesën e mbetur të kapitalit.

## **ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE**

### **NENI 24**

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit do t'i paraqiten për zgjidhje gjykatës kompetente shqiptare.

## **DISPOZITA E FUNDIT**

### **NENI 25**

Ky statut pasi perpilohët, lexohet e nenshkruhet me vullnetin e lire te tħemeluesit te tij Artan Xhori, ne prani te noterit.

Tirane me 24.03.2006

**ORTAK I VETËM**

**Artan Xhori**

